



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministarstvo za Regionalni Razvoj, Ministry of Regional Development

DATE	27.03.2025
PËR/ZA/TO:	Besim Kamberaj, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal 
NGA/OD/FROM:	Shkendije Dinaj Morina, Udhëheqëse e Divizionit Ligjor 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për miratimin e Politikës së Privatësisë të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

I nderuar Sekretar,

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim versionin përfundimtar të draftit të dokumentit "Politika e Privatësisë" për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, i cili ka për qëllim të sigurojë që të dhënat personale të mbledhura dhe përpunuara nga MZHR të trajtohen me përgjegjshmëri, në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme gjatë realizimit të aktiviteteve të saj.

Bashkëngjitur gjeni:

- Draftin e Politikës së Privatësisë për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Politika e Privatësisë e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) është e përkushtuar për mbrojtjen e të dhënave personale të individëve dhe respekton standardet ligjore dhe etike për mbrojtjen e privatësisë. Kjo politikë e privatësisë përshkruan mënyrën se si mbledhen, përdoren dhe mbrohen të dhënat personale të individëve në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës.

1. Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?

Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale kryhen nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), e cila është përgjegjëse për mbledhjen, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave personale që mbledhen gjatë zhvillimit të aktiviteteve dhe shërbimeve të ofruara nga kjo ministri. Personeli i autorizuar i MZHR-së është përgjegjës për menaxhimin e këtyre të dhënave, duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi.

2. Kategoria e të dhënave që përpunojmë

MZHR mund të mbledhë dhe përpunojë të dhëna personale nga individët dhe organizatat përmes aktiviteteve dhe shërbimeve që ofron. Këto të dhëna mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Të dhëna identifikimi: emri, mbiemri, adresa, numri i telefonit, adresa e email-it.
- Të dhëna për aktivitetet profesionale dhe edukimin: informacion mbi pozitat, trajnime dhe aftësi profesionale.
- Të dhëna financiare dhe kontraktuese: të dhëna që lidhen me financimin e projekteve dhe shërbimeve.

3. Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat tuaja personale?

Të dhënat personale përdoren për realizimin e qëllimeve të mëposhtme:

- Përbushja e detyrave ligjore dhe administrative të MZHR-së.
- Ofrimi i shërbimeve dhe mbështetje për qytetarët dhe komunitetet rajonale.
- Pjesëmarrja në projekte dhe aktivitete të zhvillimit rajonal.
- Komunikimi dhe informimi i individëve dhe organizatave për mundësi dhe shërbime të ofruara nga MZHR.
- Monitorimi dhe raportimi mbi aktivitetet dhe rezultatet e realizuara.

4. Baza ligjore për përpunim

Të dhënat personale përpunohen në përputhje me bazat ligjore të përcaktuara në legjislacionin e Kosovës, përfshirë:

- Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Rregulloret dhe akte të tjera përkatëse që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e individëve.

Përpunimi i të dhënave bëhet vetëm kur është i nevojshëm dhe në përputhje me qëllimet e specifikuar më sipër, duke respektuar të drejtat e individëve.

5. Me kë i ndajmë të dhënat personale të mbledhura?

MZHR mund të ndajë të dhënat personale të mbledhura vetëm me autoritetet kompetente të shtetit, partnerët e projektit, dhe palët e treta të autorizuar që kanë nevojë për to për të realizuar detyrat ligjore ose për të mbështetur shërbimet dhe projektet e MZHR-së. Kjo mund të përfshijë institucione të tjera publike, organizata ndërkombëtare, ose kompani të angazhuara për realizimin e aktiviteteve specifike.

Të dhënat nuk do të shpërndahen ose shiten te subjekte të tjera, përveç nëse është kërkuar nga ligji ose në rastet kur individët kanë dhënë pëlqimin e tyre të shprehur për shpërndarjen e të dhënave.

6. Cilat janë të drejtat tuaja?

Ju keni të drejtat e mëposhtme në lidhje me të dhënat tuaja personale:

- **E drejta për aksesë:** Të kërkonit informacion mbi të dhënat që ne kemi mbledhur për ju.
- **E drejta për korrigjim:** Të kërkonit që të dhënat tuaja të pasakta ose të paplota të korrigjohen.
- **E drejta për fshirje:** Të kërkonit që të dhënat tuaja të fshihen, përveç nëse ekzistojnë arsye ligjore për ruajtjen e tyre.
- **E drejta për kufizim të përpunimit:** Të kërkonit kufizimin e përdorimit të të dhënave tuaja në disa raste të caktuara.
- **E drejta për transferimin e të dhënave:** Të kërkonit që të dhënat tuaja të kalojnë tek një tjetër kontrollues të të dhënave.

7. E drejta e ankimimit

Nëse konsideroni se të drejtat tuaja të mbrojtjes së të dhënave janë shkelur, keni të drejtë të ankoheni te **Autoriteti i Mbrojtjes së të Dhënave Personale** të Kosovës. Ankesa ose kërkesa mund të dorëzohet me shkrim tek zyrët tona, përmes postimit në një zarf të mbyllur në adresën: Ministria e Zhvillimit Rajonal – Objekti ish Rilindja/ Prishtinë, Kosovë’.

8. Siguria e të dhënave personale

MZHR angazhohet për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale duke zbatuar masa të sigurta teknike dhe organizative. Kjo përfshin:

- Përdorimin e teknologjive dhe politikave për parandalimin e qasjes të paautorizuar.
- Sigurimin që të dhënat ruhen në mënyrë të sigurtë dhe të paprekura nga ndryshimi, humbja, ose shkatërrimi.

9. Përditësimi i Politikës së Privatësisë

MZHR mund të përditësojë këtë politikë të privatësisë për të pasqyruar ndryshimet ligjore, rregullore ose praktikat e menaxhimit të të dhënave personale. Çdo përditësim do të publikohet në faqen zyrtare të MZHR-së dhe do t’ju njoftojmë për çdo ndryshim të rëndësishëm që mund të ndikojë në trajtimin e të dhënave tuaja personale.

Kontakti

Për çdo pyetje, shqetësim ose kërkesë në lidhje me politikën e privatësisë, mund të kontaktoni edhe Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të MZHR-së, duke klikuar Web faqen tone: Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Kjo politikë e privatësisë është në fuqi nga data e publikimit në Web Faqen e MZHR-së